VENDIM
Nr. 166, datë 12.3.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 865, DATË 24.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MËNYRËN E KRYERJES SË PROCESIT TË AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR E PËRCAKTIMIN E TARIFAVE DHE AFATEVE KOHORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 26, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 865, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 4, pas fjalëve "... dhe institucionit përgjegjës për akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor." shtohen fjalët "... në regjistrin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe shoqëror përmes shërbimit *on-line* që institucioni përgjegjës ka në portalin "*e-Albania*".".

b) Në pikën 9, pas fjalëve "... në këtë vendim ..." shtohen "... në shërbimin *on-line* që ofrohet nëpërmjet portalit "*e-Albania*".".

c) Në fjalinë e dytë, të pikës 11, fjalët "... të cilat dorëzohen, brenda dy muajve pas marrjes së ftesës, pranë institucionit përgjegjës,..." zëvendësohen me "... të cilat ngarkohen brenda dy muajve pas marrjes së ftesës në shërbimin *on-line* që institucioni përgjegjës ka në portalin "*e-Albania",...*".

ç) Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"18. Grupi i ekspertëve të vlerësimit të jashtëm mund të marrë parasysh ose jo vërejtjet e institucionit të kujdesit shëndetësor dhe, brenda një jave, ngarkon në shërbimin *on-line* që institucioni përgjegjës ka në portalin "*e-Albania"* raportin final të vlerësimit, të firmosur nga të gjithë anëtarët e ekipit. Institucioni përgjegjës për akreditimin i përcjell një kopje të raportit institucionit të kujdesit shëndetësor.".

d) Në pikën 40, pas fjalës "... sociale ..." shtohen fjalët "... dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror,...".

2. Kërkesat dhe procedurat administrative, që, në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi janë në proces shqyrtimi nga sistemi ministror i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të vendimit nr. 865, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, në kohën e paraqitjes së tyre.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku